



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Deliverty	19-11-2021	viti god year	1
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSH-CR.5551/2021			115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.830/2021**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.830/2021 të datës 23.09.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rruga "Tahir Zajmi", Nr.258, Prishtinë, në çështjen juridike "masës disiplinore-vërejtje me shkrim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 19.11.2021, mori këtë

**V E N D I M**

**I. SHFUQIZOHET** Vendimi me numër 588/21 i datës 25.08.2021 i Komisionit Disiplinor të Organit Shqyrtues të Prokurimit si dhe Vërejtja me shkrim me numër protokollit 658/21 e datës 28.09.2021 e shqiptuar nga Udhëheqësja e Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave e Organit Shqyrtues të Prokurimit.

**II. OBLIGOHET** Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit në Organin Shqyrtues të Prokurimit, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të rishqyrtoj lëndën lidhur me „shkeljen e supozuar“ sipas kërkesës të datës 22.07.2021 të parashtruar nga Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

**III. OBLIGOHET** Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, që t'i ndërmer veprimet në pajtim me këtë vendim për zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh dhe pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim të njoftohet Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit sipas Akt emërimit të datës 11.06.2019 me numër të protokollit 604/19 në vendin e punës "Ekspert Shqyrtues" në Divizionin për Shqyrtimin e Ankesave, me datën 28.09.2021 Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit i ka

shqiptuar *"vërejtje me shkrim"* sipas vendimit me numër 588/21 të datës 25.08.2021 të Komisionit Disiplinor të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Udhëheqësja e Drejtpërdrejtë e ankuesit me datë 23.07.2021 me numër 531/21 e ka njoftuar Menaxheren e Personelit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për e-mailin e datës 22.07.2021 dhe ka kërkuar që të ndermirën masa ndaj ankuesit në pajtim me nenin 12 të Rregullores për Procedurat Disiplinore, e që një veprim i tillë i Udhëheqëses së Drejtpërdrejtë të ankuesit

është në kundërshtim me e-mailin e datës 22.07.2021 pasi që Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit ka kërkuar nga Udhëheqësja e ankuesit që të ndërmarr masa të menjëhershme për shqiptimin e vërejtjes më shkrim, komfor ligjeve në fuqi dhe kodit të mirësjelljes, rrjedhimisht pa u iniciuar procedurë disiplinore në Komision Disiplinor ndaj tij por vetëm ti shqiptohet vërejtje me shkrim.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e datës 28.09.2021 me numër 658/21 të Udhëheqëses së Drejtpërdrejtë të Organit Shqyrtues të Prokurimit me datë 23.09.2021 me numër të protokollit 4758/21 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 29.09.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Organi Shqyrtues i Prokurimit. Këshilli më datë 08.10.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 23.09.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 25.08.2021 i Komisionit Disiplinor; Procesverbali mbi shqyrtimin e shqyrtimit të masës disiplinore e datës 30.07.2021; Njoftimi i datës 23.07.2021; E-mail i datës 26.07.2021, 27.07.2021; Vendimi për emërimin e Komisionit Disiplinor; Akt emërimi i ankuesit i datës 11.06.2019; Njoftimi për Komision Disiplinor i datës 26.07.2021; E-mail i datës 22.07.2021, 21.03.2021; Raporti i ekspertit shqyrtues i datës 21.07.2021 me numër protokollit 522/21; Raporti i ekspertit shqyrtues i datës 21.07.2021 me numër të protokollit 535/21; Autorizimi i datës 06.07.2021 me numër të protokollit 522/21; Dëshmia e ngarkimit të ekspertizës në e-prokurim datë 08.10.2021; Raporti i ekspertit shqyrtues i datës 07.07.2021; Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A/02/320/2017 i datës 07.08.2017; Plotësimi i ankesës së ankuesit i datës 07.10.2021; Vërejtja e datës 28.09.2021 me numër të protokollit 658/21 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vendosjes e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore që ankesa e ankuesit të kthehet në rishqyrtim tek Udhëheqësja e tij e drejtpërdrejtë, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se ndaj ankuesit i punësuar sipas Aktit të emërimit të datës 11.06.2019 në pozitën "Ekspert Shqyrtues"

në Divizionin për Shqyrtimin e Ankesave të Organit Shqyrtues të Prokurimit, më datë 22.07.2021 nëpërmjet e-mailit zyrtar Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, ka kërkuar nga „udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit që të marr masa ndaj ankuesit <sup>pasi që më datë: "21.07.2021,</sup> është ardh ne zyrën time me një ekspertize ne dore duke mu drejtuar se gjoja paskam ndërhyre ne ekspertizën e tij dhe ja kemi ndërruar-shtuar një paragraf të mendimit të tij në ekspertize në mënyre shume arrogante dhe urdhëruese sikur me qenë ai mbikëqyrësi im" dhe po ashtu në këtë e-mail Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit ka kërkuara „nga Udhëheqësja e Drejtpërdrejtë e ankuesit që të marr masa të menjëhershme dhe ti shqiptohet vërejtja me shkrim, komfor ligjeve në fuqi si dhe kodit të mirësjelljes". Pas pranimit të e-mailit të datës 22.07.2021 të Kryesuesit të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Udhëheqësja e Drejtpërdrejtë e ankuesit me datë 23.07.2021 me numër 531/21 e njofton Menaxheren e Personelit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për e-mailin e datës 22.07.2021 dhe kërkon që të ndërmerren masat në pajtim me Procedurën Disiplinore.

Me datë 26.07.2021 me numër 536/21 Menaxherja e Personelit e Organit Shqyrtues të Prokurimit e njofton Komisionin Disiplinor të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe ia dorëzon Komisionit Disiplinor materialin e nevojshëm për shqyrtim .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit në ankesën e datës 23.09.2021 dhe plotësimin e ankesës se datës 07.10.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka kundërshtuar shqiptimin e vërejtjes më shkrim te datës 28.09.2021 nga udhëheqësja e drejtpërdrejtë e tij si dhe po ashtu ka pretenduar se Komisioni Disiplinor është emëruar nga një zyrtarë i Organit Shqyrtues të Prokurimit i cili nuk ka të drejtë e as kompetencë të emëroj Komisionin Disiplinor.

Kolegji ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit për emërimin e Komisionit Disiplinor nga ana e Kryesuesit të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit është i pa bazuar sepse Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit është njëherazi edhe Udhëheqësi më i Lartë Administrativ dhe ka kompetencë që të nxjerr vendim për emërimin e Komisionit Disiplinor, po ashtu Vendimi mbi emërimin e Komisionit Disiplinor AD HOC i datës 26.07.2021 me numër të protokollit 535/21 i marrë nga Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit është në pajtim me dispozitat e nenit 49 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe të nenit 10 paragrafit 5 nën paragrafi 5.1 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Organit Shqyrtues të Prokurimit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 588/21 të datës 25.08.2021, ka veprua në kundërshtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë procedurën disiplinore dhe masat disiplinore për nëpunësit civil.

Me dispozitat të nenit 48 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publik si dhe nenit 11 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, janë përcaktuar kompetencat e Komisionit Disiplinor, si në vijim:

**„1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca:**

- 1.1. bene shqyrtimin e fakteve dhe provave te paraqitura;
- 1.2. përcakton dhe shqipton masën disiplinore ”.

Në pajtim me këto dispozita ligjore, Komisioni Disiplinor ka mandat të dëgjoj dhe shqyrtoj provat në lidhje me shkeljen e supozuar dhe që në bazë të provave të prezantuara të vendos nëse është kryer shkelja e supozuar. Në bazë të konstatimit të shkeljes së kryer, atëherë Komisioni duhet të përcaktojë masën disiplinore, dhe me asnjë dispozitë nuk është përcaktuar e drejta e Komisionit disiplinor për të rekomanduar masat disiplinore që duhet të shqiptohen nga udhëheqësit e nëpunësve civilë.

Komisioni disiplinor, në vendimin me numër 588/21 të datës 25.08.2021, ka vendosur që “nuk ka bazë për shqiptim të masës disiplinore për shkelje të rënda serioze të detyrave të punës” mirëpo ka vërtetuar që ankuesi ka kryer shkelje të lehta të detyrave të punës, andaj ka rekomanduar shqiptimin e masës disiplinore për shkelje të lehtë disiplinore vërejtje me shkrim nga Udhëheqësja e drejtpërdrejte e ankuesit, që është në kundërshtim me kompetencat e Komisionit disiplinor.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni disiplinor ka qenë i obliguar të shqyrtojë kërkesën për shkeljen e supozuar, dhe të vendos nëse është kryer ajo shkelje e rëndë apo jo, dhe në bazë të konstatimit të shqiptoj masën disiplinore apo të hedhë poshtë si të pabazuar pretendimin për iniciimin e procedurës disiplinore, sepse në shkresën e datës 22.07.2021, nuk është kërkuar iniciimi i procedurës disiplinore në Komision Disiplinor por është kërkuar shqiptimi i „vërejtjes me shkrim” nga udhëheqësja e drejtpërdrejtë, andaj udhëheqësja e drejtpërdrejtë ka qenë e obliguar të veprojë konform me dispozitat e nenit 6 dhe nenit 13 paragrafit 4 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, ku është përcaktuar procedura e paraqitjes dhe shqyrtimit të rasteve të paraqitura për shkeljet e dyshuara të nëpunësit dhe përgjegjësia e udhëheqësit të drejtpërdrejte që të vendos nëse shkelja disiplinore është shkelje e lehtë apo e rëndë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke marrë parasysh faktin që Vërejtja me shkrim me numër protokollit 658/2021 e datës 28.09.2021 është shqiptuar nga Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit, duke u bazuar në Vendimin me numër 588/21 të datës 25.08.2021 të Komisionit Disiplinor Organit Shqyrtues të Prokurimit, i cili si vendim që është nxjerrë në kundërshtim me ligjin është shfuqizuar, dhe po ashtu duke u bazuar në faktin se me rastin e shqiptimit të vërejtjes me shkrim, nuk janë respektuar dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik.

Duke marrë parasysh faktet e lartcekura, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit është e obliguar që të rishqyrtojë lëndën lidhur me „shkeljen e supozuar” sipas kërkesës të datës 22.07.2021 të parashtruar nga Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe të vendos nëse shkelja disiplinore është shkelje e lehtë apo e rëndë sipas dispozitave ligjore të nenit 46 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.830/2021

Valentina Kaçandolli Bektashi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Kryesuesit të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit;
- Menaxheres së Personelit në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

